

Llogaritë Rajonale në Shqipëri 2013

LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI 2013

Drejtor botimi: **Mirela MUÇA**

Përpunimi Statistikor: Drejtoria e Llogarive Kombëtare

© Copyright INSTAT 2015

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë,
pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Përpunimi në kompjuter: **Teuta Topi**

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Shtypshkronja "ADELPRINT"
Rruga "Muhamet Gjollësja", Nr. 17, Zogu i Zi, Tiranë / Albania
e-mail: adelprint@gmail.com
www.adelprint.com.al

Parathënie

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2013 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev2, për seritë kohore vjetore 2008 - 2013) duke marrë për bazë vlerësimet më të fundit vjetore të publikuara më 30 Maj 2015, si dhe duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimeve vjetore dhe rajonale në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbledhen dhe përpunohen statistikat rajonale evropiane. Statistikat Rajonale janë themeli i Sistemit Statistikor Evropian, të cilat përdoren për një sërë qëllimesh.

Klasifikimi sipas NUTS është prezantuar nga Bashkimi Evropian për një ndarje të standardizuar me qëllim:

- i) Mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave në nivel rajonal;
- ii) Analizat socio-ekonomike të rajoneve;
- iii) Për alokimin e fondeve strukturore për zhvillim.

Prodhimi i statistikave rajonale ekonomike ka rëndësi të madhe në marrjen e vendimeve të rëndësishme në nivel kombëtar por edhe në politikën rajonale të BE-së për alokimin e fondeve strukturore. Zhvillimi rajonal është i lidhur me nxitjen e investimeve si rrjedhim i proceseve vendim marrëse me mbështetje nga statistikat rajonale të disponueshme. Informacioni statistikor në këtë publikim shoqërohet nga koncepte dhe definicione bazë të aplikuara në Llogaritë Kombëtare dhe Rajonale si dhe me harta e grafikë të cilat reflektojnë rajonalizimin e treguesve makroekonomikë. Informacioni i detajuar mbi nivelin e zhvillimit ekonomik sipas rajoneve dhe qarqeve do të jetë i dobishëm në analizat ekonomike duke ndjekur ndryshimet strukturore të rajoneve.

INSTAT ka rishikuar serinë kohore 2008-2013 të treguesve të Llogarive Kombëtare më 30 Maj 2015 dhe ka publikuar edhe revizionimeve më të fundit.

Këto ndryshime janë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji.

Publikimi përmban rezultate të llogaritjeve të Produktit të Brendshëm Bruto dhe përbërësve të tij për vitet 2008-2013 sipas 3 rajoneve statistikore niveli 2 dhe 12 rajoneve statistikore niveli 3 të harmonizuara me ndarjen e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Për të lehtësuar e ndihmuar lexuesit, të dhënat janë shprehur në Euro, Dollarë (USD) si dhe në treguesin e Standardit të Fuqisë Blerëse (PPS - Purchaser Power Standard) për efekte të krahasimeve ndërkombëtare.

¹ http://www.instat.gov.al/media/298522/produkti_i_brendshem_bruto_semifinal_2013.pdf

PARATHËNIE	3
PËRMBAJTJA	5
1. NDARJA E TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË RAJONE STATISTIKORE	7
2. LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2013	7
2.1 PBB sipas Rajoneve Statistike nivelet 2 dhe 3	8
2.2 Kontributi në rritjen ekonomike të PBB-së sipas rajoneve statistikore	10
2.3 Rritja ekonomike e PBB-së sipas rajoneve statistikore	11
2.4 PBB për frymë sipas Rajoneve Statistike nivelet 2 dhe 3	11
2.5 PBB për frymë në PPS për Shqipërinë	12
2.6 Pësia ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2/3, viti 2013	13
2.7 Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe sipas Qarqeve	14
2.8 Pozicioni i Tiranës në Republikën e Shqipërisë	24
2.9 Diversiteti i rajoneve statistikore në Shqipëri	24
ANEKSET	26
Aneks A.1: Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011	26
Aneks A.2: PBB korrente sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2013	28
Aneks A.3: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2013	29
Lista e Tabelave sipas Rajoneve Statistike	
Tabela B.1. Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistike Nivel 1, 2, 3 për vitet 2008-2013	30
Tabela B.2. Produkti i Brendshëm Bruto në çmime korrente	31
Tabela B.3. Produkti i Brendshëm Bruto me çmimet e vitit të mëparshëm	32
Tabela B.4. Produkti i Brendshëm Bruto në Euro	33
Tabela B.5. Produkti i Brendshëm Bruto në PPS	34
Tabela B.6. Rritja Reale e Produktit të Brendshëm Bruto	35
Tabela B.7. Popullsia mesatare në Shqipëri	36
Tabela B.8. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë në Lekë	37
Tabela B.9. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, në Euro	38
Tabela B.10. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, në PPS	39
Tabela B.11. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, AL=100	40
Tabela B.12. Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, EU28=100	41
Tabela B.13. Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto e ndarë në degë të ekonomisë sipas e ndarjes Statistike Rajonale 2/3 viti 2013* (Dega=100%)	42
Tabela B.14. Ndarja e degëve ekonomike të VSHB-së për Rajonet Statistike nivel 2/3, viti 2013* (Rajoni=100%)	43
Tabela B.15. Rajoni Statistikor Veri	44
Tabela B.16. Rajoni Statistikor Qendër	45
Tabela B.17. Rajoni Statistikor Jug	46
Tabela B.18. Qarku Dibër	47
Tabela B.19. Qarku Durrës	48
Tabela B.20. Qarku Kukës	49
Tabela B.21. Qarku Lezhë	50
Tabela B.22. Qarku Shkodër	51
Tabela B.23. Qarku Elbasan	52
Tabela B.24. Qarku Tiranë	53
Tabela B.25. Qarku Berat	54
Tabela B.26. Qarku Fier	55
Tabela B.27. Qarku Gjirokastrë	56
Tabela B.28. Qarku Korçë	57
Tabela B.29. Qarku Vlorë	58

1. Ndarja e Territorit të Republikës së Shqipërisë në Rajone Statistikore

Në 28 Prill 2011 EUROSTAT konfirmoi propozimin e Institutit të Statistikave, të aprovuar nga Këshilli i Ministrave , për ndarjen e Shqipërisë në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, përbërja e të cilave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Struktura rajonale e Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Rajoni Statistikor Niveli 1	Rajoni Statistikor Niveli 2	Rajoni Statistikor Niveli 3
Republika e Shqipërisë	Veri	Dibër
		Durrës
		Kukës
		Lezhë
		Shkodër
	Qendër	Elbasan
		Tiranë
		Berat
	Jug	Fier
		Gjirokastrë
		Korçë
		Vlorë

Ndarja e territorit të Republikës së Shqipërisë është në koherencë me rregulloren e Komisionit Evropian (KE-së) nr 1059/2003 mbi Parlamentin Evropian si dhe me Këshillin e tij më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të njësive territoriale për statistikat (NUTS).

Numri i popullsisë për çdo njësi jo-administrative në nivel NUTS 2 është i harmonizuar me intervalin e vendosur nga Komisioni Evropian nga 800 mijë banorë në një maksimum prej 3 milionë banorësh.

Rajonet statistikore Niveli 3 janë njësi administrative (Qarqet). Numri mesatar i popullsisë për nivelin 3 është 241.447 banorë për vitin 2013 brenda intervalit 150 në 800 mijë banorë.

NUTS	Numri minimal i banorëve	Numri maksimal i banorëve
NUTS 1	3.000.000	7.000.000
NUTS 2	800.000	3.000.000
NUTS 3	150.000	800.000

2. Llogaritë Rajonale në Shqipëri për vitin 2013

Vlerësimi i Llogarive Rajonale në Shqipëri bazohet në konceptet e Llogarive Kombëtare Vjetore. Ky është publikimi i pestë i Statistikave Rajonale në Shqipëri dhe është përpiluar duke ndjekur direktivat e metodologjisë ESA (Standarteve Evropiane të Llogarive), kapitulli XIII- Llogaritë Rajonale. Indikatorët rajonalë përfshijnë të dhëna për periudhën 2008-2013 të publikuara këto sipas rajoneve statistikore niveli 2 dhe 3 dhe sipas degëve kryesore të ekonomisë.

² Vendimi i KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës" "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Publikimi përfshin indikatorët e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB), Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) të shprehura këto me çmime korrente dhe konstante për vitet 2008-2013. Treguesit makroekonomikë rajonalë janë të disponueshëm në 3 rajone statistikore nivel 2 si dhe në 12 rajone statistikore nivel 3 (e barazvlefshme me ndarjen administrative Qark). Vlerësimet janë në linjë me kërkesat e EUROSTAT.

2.1 PBB sipas Rajoneve Statistikore nivelet 2 dhe 3

Në vitin 2013, sipas rajoneve statistikore niveli 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente ishte 1.350,6 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 1,11 % krahasuar me vitin 2012.

Në vitin 2013 sipas rajoneve statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB me çmime korrente ishte 608,4 miliardë lekë ose 45,1 % ndaj totalit të PBB-së së vendit. Krahasuar me vitin 2012, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 1,6 %.

PBB me çmime korrente në Rajonin Jug ishte 422,3 miliardë lekë ose 31,3 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2012, PBB me çmime korrente u rrit me 1,2 %. PBB me çmime korrente në Rajonin Veri ishte 319,8 miliardë lekë ose 23,7 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2012, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 0,1 %.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (qarqet) vlera më e ulët në PBB paraqitet në qarkun Kukës me 31 miliardë lekë ose 2,3 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2012, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 5,6 %.

Vlera më e lartë në PBB paraqitet në qarkun e Tiranës me rreth 507 miliardë lekë ose 37,6 % e totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2012, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 1,0 %.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa nga rezultatet më të rëndësishme të Llogarive Kombëtare Rajonale në Shqipëri.

Ne aneksin A.2 mund të gjeni edhe hartën e shpërndarjes së PBB-së sipas rajoneve statistikore NUTS 3.

PBB me çmime korrente, PBB për frymë e trajtuar sipas rajoneve statistikor nivel 2/3, viti 2013*


Rajonet Statistikore niveli 2/3		PBB çmime korrente		PBB çmime korrente	PBB çmime korrente	Struktura ndaj PBB-së		Kontributi ndaj rritjes Reale		PBB për frymë	PBB për frymë	PBB për frymë	Struktura indeksit për frymë ndaj PBB-së
		mIn Lekë	mIn Euro	mIn USD	%	%	mijë Lekë	Euro	USD				
AL	Republika e Shqipërisë	1.350.555	9.629	12.781	100	1,11	466	3.323	4.411				100
AL01	Veri	319.839	2.280	3.027	23,7	0,03	372	2.652	3.520				79,8
AL011	Dibër	42.524	303	402	3,1	-0,001	307	2.191	2.908				65,9
AL012	Durrës	129.726	925	1.228	9,6	0,25	471	3.359	4.459				101,1
AL013	Kukës	30.998	221	293	2,3	0,12	358	2.554	3.391				76,9
AL014	Lezhë	41.885	299	396	3,1	-0,14	303	2.159	2.866				65,0
AL015	Shkodër	74.707	533	707	5,5	-0,19	338	2.406	3.194				72,4
AL02	Qendër	608.429	4.338	5.758	45,1	0,71	557	3.973	5.274				119,6
AL021	Elbasan	101.238	722	958	7,5	0,35	334	2.382	3.162				71,7
AL022	Tiranë	507.191	3.616	4.800	37,6	0,36	643	4.585	6.085				138,0
AL03	Jug	422.287	3.011	3.996	31,3	0,37	446	3.183	4.225				95,8
AL031	Berat	49.828	355	472	3,7	0,02	343	2.447	3.248				73,6
AL032	Fier	177.698	1.267	1.682	13,2	0,49	559	3.985	5.289				119,9
AL033	Gjirokastrë	35.083	250	332	2,6	-0,07	477	3.399	4.511				102,3
AL034	Korçë	78.886	562	747	5,8	0,02	349	2.487	3.301				74,8
AL035	Vlorë	80.792	576	765	6,0	-0,09	442	3.149	4.180				94,8

*Vlerësimet për vitin 2013 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

2.2 Kontributi në rritjen ekonomike të PBB-së sipas Qarqeve

Në vitin 2013, në rritjen prej 1,11 % të PBB-së në terma reale ndaj vitit 2012, kontributi sipas rajoneve statistikore niveli 3 (qarqet) paraqitet si më poshtë: Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2013, e pati qarku Fier me +0,49 pikë përqindje, më pas renditet qarku Tiranë me +0,36 pikë përqindje dhe qarku Elbasan me +0,35 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë qarku Shkodër me -0,19 pikë përqindje, i pasuar me qarkun Lezhë me një kontribut prej -0,14 pikë përqindje dhe qarkun Vlorë me një kontribut prej -0,09 pikë përqindje.

Fig.1. Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike në vitin 2013



2.3 Rritja ekonomike e PBB-së sipas rajoneve statistikore

Produkti i Brendshëm Bruto në vitin 2013, shënoi një rritje ekonomike reale në krahasim me vitin 2012 me 1.11 %.

Në vitin 2013 sipas rajoneve statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB me çmime korente ishte 608,4 miliardë lekë ose 45,1 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2012, për rajonin Qendër PBB në terma reale shënoi një rritje prej 1,6 %. PBB me çmime korente në Rajonin Jug ishte 422,3 miliardë lekë ose 31,3 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2012, në Rajonin Jug PBB në terma reale u rrit me 1,2 %. PBB me çmime korente në Rajonin Veri ishte 319,8 miliard lekë ose 23,6 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2012, PBB në terma reale në Rajonin Veri shënoi një rritje prej 0,1 %.

Në krahasim me vitin 2012 struktura e PBB-së, niveli 2 nuk ka patur ndryshime të rëndësishme, siç vihet re në Tab.1.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3 (qarqet) rritjen më të lartë e shënoi qarku Kukës me një rritje në terma realë prej 5,6 %. Më tej me rritje më të lartë vijon qarku Elbasan me një rritje në terma realë prej 4,8 % dhe qarku Fier me një rritje në terma realë prej 3,8 %. Ndër qarqet me një rënie në totalin e ekonomisë paraqitet qarku Lezhë me një rënie në terma realë prej 4,4%. Më tej vjen qarku Shkodër me një rënie në terma realë prej 3,3 % dhe qarku Gjirokastrë me një rënie në terma realë prej 2,8 %.

PBB reale për vitin 2013 pati variacione në nivelet e rritjes sipas rajoneve statistikore nivel 3. Niveli i rritjes në disa vite të veçanta dhe në disa qarqe të veçanta varet nga kontributi individual i secilit qark në totalin e PBB-së, nga struktura e degëve të ekonomisë, etj. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ritmet e rritjes sipas rajoneve statistikore nivel 3:

Rritja Reale e Produktit të Brendshëm Bruto

Qarku	Rritja reale e PBB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	3,4	3,7	2,5	1,4	1,1
Qarku=100					
Dibër	4,0	7,4	-1,6	12,9	-0,02
Durrës	2,9	11,3	-5,7	0,9	2,6
Kukës	4,3	3,8	5,9	-3,1	5,6
Lezhë	3,0	-1,8	1,7	6,6	-4,4
Shkodër	4,3	6,8	0,0	-2,4	-3,3
Elbasan	2,4	12,9	-1,1	-2,5	4,8
Tiranë	3,9	0,5	0,9	1,9	1,0
Berat	3,1	6,8	7,4	-7,6	0,5
Fier	1,6	6,7	13,9	7,6	3,8
Gjirokastrë	3,3	4,6	19,0	7,5	-2,8
Korçë	3,4	1,5	3,2	1,5	0,4
Vlorë	3,2	-4,5	7,2	-6,3	-1,4


2.4 PBB për frymë sipas Rajoneve Statistike nivelet 2 dhe 3

Në vitin 2013 niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë) ishte rreth 466 mijë lekë. Krahësuar me vitin 2012 PBB për frymë u rrit me 1,44 %.

Në rajonet statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në vitin 2013 ishte rreth 557 mijë lekë ose 19,6 % mbi mesataren e vendit. Krahësuar me vitin 2012, PBB për frymë në rajonin Qendër shënoi një rritje prej 1,7 %. Në rajonin Veri PBB për frymë në vitin 2013, ishte rreth 372 mijë lekë ose 20,2 % nën mesataren e vendit. Krahësuar me vitin 2012, PBB për frymë në rajonin Veri shënoi një rritje prej 0,4 %. Në rajonin Jug PBB për frymë në vitin 2013 ishte rreth 446 mijë lekë ose 4,2 % nën mesataren e vendit. Krahësuar me vitin 2012, PBB për frymë në rajonin Jug shënoi një rritje prej 1,8 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore niveli 3 (qarqe) në vitin 2013 ishte Tirana me rreth 643 mijë lekë ose 38,0 % mbi mesataren e vendit dhe pati një rritje prej 0,7 % krahasuar me vitin 2012. Më pas renditet qarku Fier me rreth 559 mijë lekë ose 19,9 % mbi mesataren, i cili pati një rritje prej 4,4 % krahasuar me vitin 2012. Më pas renditet qarku Gjirokastrë me rreth 477 mijë lekë ose 2,3 % mbi mesataren, i cili pati një rënie prej 2,2 % krahasuar me vitin 2012. Më pas renditet qarku i Durrësit me rreth 471 mijë lekë ose 1,1 % mbi mesataren e vendit, i cili pati një rritje prej 1,9 % krahasuar me vitin 2012. PBB për frymë për qarqet e tjera ishte nën mesataren e vendit ku më e ulta ishte ajo e qarkut Lezhë me rreth 303 mijë lekë ose 35,0 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon qarku Dibër, me rreth 307 mijë lekë ose 34,1 % nën mesataren e vendit. PBB-ja për frymë në qarkun Korçë është rreth 349 mijë lekë, ose 25,18 % nën mesataren e vendit. Në aneksin A.3 ndodhet edhe harta e PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore niveli 3.

Fig.2. PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 krahasuar me mesataren kombëtare (në mijë Lekë) për vitin 2013



2.5 PBB për frymë në PPS për Shqipërinë

Si krahasim me nivelin ekonomik të vendeve të BE-së përdoret koeficienti i Standartit të Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS), i llogaritur nga EUROSTAT sipas deflatorëve të vendeve përkatëse.

PPS është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatët (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse në vitin 2013 është 21.490 PPS ose 28,9 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100. Sipas rajoneve statistikore niveli 2 në Rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2013 ishte 34,5 %, ndërsa në rajonet Veri dhe Jug ishte përkatësisht 23,0 % dhe 27,6 %.

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse

Rajoni Statistikor	PPB për frymë në PPS (BE28=100) në 2013
Republika e Shqipërisë	28,9
NUTS 2	
Veri	23,0
Qendër	34,5
Jug	27,6

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme:

<http://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/data/database>

PBB për frymë në BE për vitin 2013

Në vitin 2013 PBB për frymë, i shprehur në termat e Standarteve të Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standards-PPS) në 272 rajone NUTS 2 të BE28 (28 vendet anëtare të Bashkimit Europian) varion nga 30 % të mesatares së BE28, në rajonin "Severozapaden" të Bullgarisë, deri në 325 % të mesatares në "Inner London" të Britanisë së madhe. Për informacion të hollësishëm ndiqni adresën e mëposhtme:


<http://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/6839731/1-21052015-AP-EN.pdf/c3f5f43b-397c-40fd-a0a4-7e68e3bea8cd>

2.6 Pesha ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2/3, viti 2013

Në rajonin statistikor niveli 3 pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënuar në qarkun Kukës me 2,3 % dhe në qarkun Gjirokastrë me 2,6 %. Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranë me 37,6 %.

Në vitin 2013 pesha ndaj PBB-së për Rajonin Qendër ishte 45,1 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Jug ishte 31,3 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Veri ishte 23,6 % e totalit të Shqipërisë.

Pesha ndaj PBB-së në sipas rajoneve statistikore niveli 2,3 viti 2013



2.7 Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe sipas qarqeve

Në vitin 2013, **dega e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit**, në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 22,5 % të totalit të ekonomisë. Dega e bujqësisë dhe peshkimit pati një rritje prej 3,9 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha që ka pasur aktiviteti i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit varion nga 5,0 % në qarkun Tiranë, në 49,5 % në qarkun Berat. Pjesa më e madhe e rajoneve statistikore nivel 2/3 kishin peshën e treguesve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit mbi mesataren e vendit. Pesha e degës së bujqësisë në rajonet statistikore specifike është paraqitur në tabelën më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Bujqësisë në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	19,41	20,66	20,96	21,66	22,50
Qarku=100					
Dibër	36,98	38,41	39,92	45,81	46,41
Durrës	14,25	14,57	14,83	15,88	17,20
Kukës	28,90	31,48	39,11	34,19	34,56
Lezhë	28,18	32,51	30,56	35,23	36,89
Shkodër	30,05	30,75	27,93	31,56	34,49
Elbasan	28,14	30,17	35,24	39,40	39,73
Tiranë	4,12	4,58	4,76	4,83	5,02
Berat	40,40	40,56	44,13	45,74	49,49
Fier	39,75	40,52	33,46	33,33	33,51
Gjirokastrë	34,28	33,66	33,07	28,81	29,86
Korçë	35,83	36,01	36,61	35,71	39,12
Vlorë	24,40	24,73	25,90	24,08	23,18

Dega e industrisë, e cila përfshin industrinë nxjerrëse dhe përpunuese, energji, uji në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 14,4 % të totalit të ekonomisë. Dega e industrisë pati një rritje prej 8,5 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e industrisë varioi nga 6,9 % në qarkun Gjirokastrë e deri në 32,3 % në qarkun Fier. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së industrisë mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Korçë, Fier, Durrës dhe Elbasan.

Pesha e degës së industrisë në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Industrisë në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	10,93	13,82	13,53	13,31	14,44
Qarku=100					
Dibër	21,18	22,40	16,34	14,26	16,22
Durrës	12,32	15,39	15,81	13,63	14,89
Kukës	13,79	13,30	5,52	8,71	11,05
Lezhë	7,87	10,95	10,59	12,51	10,74
Shkodër	15,59	15,06	11,25	11,87	13,99
Elbasan	14,02	16,08	17,30	11,36	12,30
Tiranë	8,06	11,27	10,50	10,67	11,03
Berat	8,87	10,78	12,59	11,18	11,02
Fier	16,73	21,66	27,09	28,82	32,29
Gjirokastrë	7,69	8,40	5,89	7,84	6,97
Korçë	11,11	12,35	10,74	7,29	7,84
Vlorë	8,49	12,24	10,42	11,22	13,02

Dega e ndërtimit, përbënte 11,93 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e ndërtimit pati një rënie prej 9,3 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e ndërtimit varioi nga 5,4 % në qarkun Dibër, në 24,83 % në qarkun Kukës. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së ndërtimit mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Tiranë, Vlorë, dhe Kukës.

Pesha e degës së ndërtimit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Ndërtimit në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	17,29	14,87	14,62	13,15	11,93
Qarku=100					
Dibër	7,13	6,90	7,22	6,13	5,40
Durrës	13,75	11,41	15,13	15,95	14,64
Kukës	19,53	17,59	22,15	26,73	24,83
Lezhë	16,97	13,67	13,26	9,78	9,84
Shkodër	11,66	15,11	17,54	10,94	10,08
Elbasan	10,58	8,15	5,40	9,41	9,81
Tiranë	23,78	20,96	18,71	15,61	13,79
Berat	13,87	11,80	9,85	7,84	6,06
Fier	9,01	7,16	8,37	8,16	6,88
Gjirokastrë	14,61	13,01	8,51	14,96	13,72
Korçë	9,07	7,96	8,63	9,81	8,78
Vlorë	21,33	16,80	21,06	16,66	16,85

Dega e tregtisë, hotelërisë dhe transportit përbënte 18,18 % ndaj totalit të ekonomisë në gjenerimin e vlerës së shtuar bruto kombëtare.

Dega e tregtisë, hotelërisë, transportit pati një rënie prej 6,4 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 7,0 % në qarkun Kukës, në 23,37 % në qarkun Durrës. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës së tregtisë, hotelërisë, transportit mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Durrës, Tiranë dhe Gjirokastrë.

Pesha e degës së tregtisë, hotelërisë, transportit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Tregtisë në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	19,29	18,98	19,15	19,42	18,18
Qarku=100					
Dibër	7,78	6,66	8,25	10,08	7,19
Durrës	30,77	28,76	26,99	24,93	23,37
Kukës	9,26	10,70	7,12	7,36	7,00
Lezhë	16,44	12,47	14,89	15,20	14,01
Shkodër	11,96	9,78	14,75	18,57	13,69
Elbasan	18,69	21,60	17,72	16,29	14,56
Tiranë	22,93	24,46	23,34	22,57	23,25
Berat	12,45	11,65	11,33	13,92	11,69
Fier	14,50	11,71	13,86	13,83	11,49
Gjirokastrë	13,21	10,74	20,15	22,29	21,05
Korçë	13,15	12,17	16,99	20,83	17,58
Vlorë	15,75	12,74	16,18	19,83	16,90

Dega e informacionit dhe komunikacionit, përbënte 3,16 % të totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare. Dega e informacionit dhe komunikacionit pati një rënie prej 12,6 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e informacionit dhe komunikacionit varioi nga 0,87 % në qarkun Elbasan, në 6,32 % në qarkun Tiranë. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës informacionit dhe komunikacionit mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Gjirokastrë dhe Tiranë.

Pesha e degës informacionit dhe komunikacionit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Informacionit dhe komunikimit në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	5,38	4,16	3,89	3,61	3,16
Qarku=100					
Dibër	4,13	3,09	1,69	1,35	1,23
Durrës	3,52	3,29	1,55	1,40	1,23
Kukës	5,05	3,32	1,49	1,38	1,41
Lezhë	4,48	3,51	1,74	1,46	1,49
Shkodër	4,36	3,44	1,78	1,67	1,58
Elbasan	3,76	2,68	0,96	0,89	0,87
Tiranë	7,19	5,54	7,87	7,45	6,32
Berat	5,17	3,99	1,58	1,53	1,35
Fier	2,81	2,24	1,27	1,03	0,97
Gjirokastrë	7,69	5,31	2,10	1,76	1,88
Korçë	4,57	3,78	1,14	1,02	1,06
Vlorë	4,60	4,07	1,74	1,66	1,78

Dega e aktiviteteve financiare dhe të siguracionit, në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 2,58 % të totalit të ekonomisë. Dega e aktiviteteve financiare dhe të siguracionit pati një rënie prej 7,4 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në degën e aktiviteteve financiare dhe të siguracionit varioi nga 1,34 % në qarkun Berat, në 3,77 % në qarkun Tiranë. Rajonet statistikore niveli 3 me peshën e degës financiare, pasuritë e pa-tundshme, si dhe qiradhënia mbi mesataren e vendit janë përkatësisht: Gjirokastrë dhe Tiranë.

Pesha e degës financiare dhe të siguracionit në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Aktiviteteve financiare e siguracionit në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	2,75	2,75	2,96	2,78	2,58
Qarku=100					
Dibër	0,79	0,89	1,05	1,62	1,51
Durrës	1,74	1,59	1,82	1,64	1,49
Kukës	1,33	1,35	1,40	1,70	1,47
Lezhë	2,22	2,11	2,35	3,05	2,91
Shkodër	1,62	1,56	1,66	2,03	1,91
Elbasan	1,23	1,16	1,33	1,92	1,67
Tiranë	4,29	4,58	5,05	4,11	3,77
Berat	1,53	1,47	1,60	1,47	1,34
Fier	1,41	1,34	1,30	1,46	1,55
Gjirokastrë	3,16	2,85	2,67	3,14	2,98
Korçë	2,27	2,08	2,13	2,63	2,40
Vlorë	2,00	2,08	2,00	2,54	2,40

Dega e aktivitete të pasurive të paluajtshme, në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 7,33 % ndaj totalit të ekonomisë.

Dega e aktivitete të pasurive të paluajtshme pati një rritje prej 6,0 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 3,39 % në qarkun Kukës, në 10,42 % në qarkun Durrës. Pesha e rajoneve statistikore niveli 3 mbi mesataren e vendit ishin: Durrës, Tiranë dhe Vlorë.

Pesha e degës së aktivitete të pasurive të paluajtshme në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	7,65	7,09	6,93	6,92	7,33
Qarku=100					
Dibër	3,92	3,50	3,93	3,30	3,89
Durrës	10,57	9,27	9,49	10,06	10,42
Kukës	3,50	3,29	3,23	3,18	3,39
Lezhë	6,97	6,77	6,98	6,53	7,39
Shkodër	6,60	6,03	5,96	6,11	6,85
Elbasan	5,63	4,82	5,06	5,26	5,59
Tiranë	9,20	8,86	8,81	8,79	9,18
Berat	3,64	3,30	3,31	3,50	3,94
Fier	5,43	4,72	4,21	3,73	3,98
Gjirokastrë	5,66	5,21	4,89	4,07	4,71
Korçë	5,78	5,50	5,12	5,15	5,61
Vlorë	8,43	8,48	7,43	8,33	9,03

Dega e aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike, në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 5,05 % ndaj totalit të ekonomisë.

Dega e aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike pati një rritje prej 12,6 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 0,97 % në qarkun Kukës, në 9,27 % në qarkun Tiranë. Pesha e rajoneve statistikore niveli 3 mbi mesataren e vendit ishin: Tiranë dhe Durrës.

Pesha e degës së aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Aktiviteteve profesionale teknike, shkencore në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	3,35	3,20	3,36	4,49	5,05
Qarku=100					
Dibër	0,56	0,31	2,61	1,63	1,56
Durrës	3,51	3,60	2,50	5,58	5,72
Kukës	0,89	1,15	2,52	0,86	0,97
Lezhë	1,86	1,23	2,80	2,57	2,08
Shkodër	1,67	2,51	3,90	1,99	1,52
Elbasan	1,44	1,12	1,76	1,39	1,64
Tiranë	5,72	5,52	4,86	7,75	9,27
Berat	0,63	0,52	1,55	1,03	1,16
Fier	1,16	1,21	1,99	2,55	2,33
Gjirokastrë	0,70	0,38	4,53	1,79	2,40
Korçë	1,48	1,37	1,91	2,68	2,43
Vlorë	2,41	2,47	2,56	1,70	2,10

Dega e administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë duke përfshirë administratën publike dhe të mbrojtjes; sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor, në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare, përbënte 12,75 % ndaj totalit të ekonomisë.

Dega e administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë pati një rritje prej 1,8 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 6,47 % në qarkun Fier, në 15,61 % në qarkun Gjirokastrë. Shumica e rajoneve statistikore niveli 3 me peshën e degës së shërbimeve të tjera ishin mbi mesataren e vendit.

Pesha e degës së administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	11,50	11,59	11,83	12,53	12,75
Qarku=100					
Dibër	16,54	15,52	16,93	14,78	15,43
Durrës	7,33	6,74	7,49	9,47	9,68
Kukës	17,48	17,66	16,80	14,74	14,68
Lezhë	14,06	14,65	15,21	12,23	13,05
Shkodër	13,81	13,55	13,21	13,22	14,07
Elbasan	14,73	11,87	12,83	12,61	12,56
Tiranë	11,00	11,59	12,56	14,73	14,78
Berat	12,10	12,41	11,94	12,79	13,08
Fier	8,42	7,66	6,98	6,50	6,47
Gjirokastrë	12,26	18,84	16,49	14,46	15,61
Korçë	13,96	14,24	13,80	13,38	13,82
Vlorë	11,20	12,75	11,06	12,01	12,96

Dega e arte, argëtim, çlodhje etj, përbënte 2,08 % ndaj totalit të ekonomisë në gjenerimin e Vlerës së Shtuar Bruto kombëtare.

Dega e arte, argëtim, çlodhje pati një rënie prej 2,5 % në krahasim me vitin 2012.

Sipas rajoneve statistikore niveli 3, pesha në këtë degë varioi nga 0,53 % në qarkun Fier, në 3,58 % në qarkun Tiranë. Pesha e rajoneve statistikore niveli 3 mbi mesataren e vendit ishin: Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.

Pesha e degës së arte, argëtim, çlodhje në rajonet statistikore specifike është paraqitur më poshtë:

Pesha sipas degëve të ekonomisë

Rajonet Statistikore	Pesha e Degës së Shërbimeve të tjera në gjenerimin e VSHB-së				
	2009	2010	2011	2012	2013
Republika e Shqipërisë	2,46	2,87	2,77	2,13	2,08
Qarku=100					
Dibër	0,99	2,31	2,06	1,04	1,16
Durrës	2,25	5,37	4,40	1,46	1,35
Kukës	0,28	0,14	0,66	1,15	0,62
Lezhë	0,95	2,14	1,61	1,43	1,59
Shkodër	2,69	2,21	2,03	2,06	1,82
Elbasan	1,77	2,35	2,38	1,47	1,27
Tiranë	3,70	2,65	3,54	3,50	3,58
Berat	1,33	3,51	2,12	1,01	0,87
Fier	0,77	1,77	1,47	0,61	0,53
Gjirokastrë	0,75	1,60	1,69	0,87	0,80
Korçë	2,77	4,53	2,94	1,50	1,37
Vlorë	1,41	3,64	1,65	1,97	1,77

2.8 Pozicioni i Tiranës në Republikën e Shqipërisë

Qarku Tiranë, ku përfshihet kryeqyteti i Shqipërisë, midis 12 njësive statistikore nivel 3 ka pozicion të rëndësishëm. Këtu janë shumica e institucioneve qeveritare si dhe zyrat qendrore të kompanive më të rëndësishme multi-rajonale³.

Në vitin 2013 nga të dhënat më të fundit të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 Tirana kishte një popullsi prej 27,07 % të totalit të popullsisë në nivel vendi si dhe përbënte rreth 38,2 % të PBB-së në nivel vendi. PBB për banorë në qarkun Tiranë ishte 41,5 % mbi mesataren e vendit.

Disa nga faktorët kryesorë që e veçojnë qarkun Tiranë nga qarqet e tjera janë:

- Përqëndrimi i vlerës së shtuar të sektorit të ndërtimit
- Sektorët e shërbimeve (bankat, sigurimet, si dhe telekomunikacioni) , etj
- Niveli i pagave mesatare i punonjësve është më i lartë mesatarisht në krahasim me rajonet e tjera
- Fluksi hyrës i punonjësve që vijnë nga rajonet e tjera⁴

2.9 Diversiteti i rajoneve statistikore në Shqipëri

Rajonet Statistikore në Shqipëri Veri, Qendër dhe Jug kanë karakteristika të ndryshme demografike, në strukturën e degëve si dhe në performancën e tyre ekonomike.

Veriu ka një sipërfaqe prej 37,9 % të territorit, në vend të dytë për nga madhësia, dhe ka një popullsi prej 29,68 % ndaj totalit të vendit.

Rajoni Qendër ka një sipërfaqe prej 16,9 % të territorit, me përqindjen më të madhe të popullsisë prej 37,68 %, ndërsa rajoni Jug ka sipërfaqen më të madhe prej 45,2 %, me një përqindje të popullsisë prej 32,64 % ndaj totalit.

Këto variacione në popullsinë rajonale reflektohen në masën e VSHB-së së prodhuar. Ndryshueshmëria midis rajoneve në përmasa të tyre bëjnë të vështirë krahasimin e performancës rajonale ekonomike duke përdorur të dhëna absolute. Këto variacione maten duke përdorur indikatorin për frymë të popullsisë. Rritja ekonomike mund të variojë nga rritja për frymë në rajone ku popullsia është rritur ose zvogëluar. Për një informacion më të detajuar konsultohuni me tabelën më poshtë:

³ Kompani me aktivitet në më shumë se një rajon brenda Republikës së Shqipërisë

⁴ Commuters - Njerëz që punojnë në një rajon dhe jetojnë në një rajon tjetër


Tregues Rajonalë viti 2013

Rajoni Statistikor		Sipërfaqja km ²	Popullsia mesatare 2013 ⁵ nr.	Dendësia e Popullsisë Banorë/km ²
Niveli 1	Shqipëria	28.748	2.897.369	100,8
AI=100%				
Niveli 2	Veri	37,90	29,68	78,9
	Qendër	16,90	37,68	224,7
	Jug	45,20	32,64	72,8
Niveli 3				
Veri	Dibër	9,00	4,78	53,5
	Durrës	2,70	9,50	354,7
	Kukës	8,30	2,99	36,3
	Lezhë	5,60	4,77	85,9
	Shkodër	12,40	7,64	62,1
Qendër	Elbasan	11,10	10,46	94,9
	Tiranë	5,70	27,22	481,3
Jug	Berat	6,30	5,01	80,2
	Fier	6,60	10,97	167,6
	Gjirokastrë	10,00	2,54	25,6
	Korçë	12,90	7,81	61,0
	Vlorë	9,40	6,31	67,7

⁵ Popullsia mesatare është mesatarja e popullsisë midis dy viteve të njëpasnjëshëm në fillim të vitit : 01/01/2013 dhe 01/01/2014

Anekset


Aneks A.1: Ndarja e Rajoneve statistikore NUTS 2 viti 2011



Kodet e komunave dhe bashkive


1 Berat	64 Gracen	127 Lekaj	190 Shëngjin	253 Rubik	316 Rrethinat
2 Kutalli	65 Grekan	128 Luz I Vogël	191 Shënkoll	254 Selitë	317 Shalë
3 Lumas	66 Kajan	129 Rrogozhinë	192 Ungrej	255 Gjocaj	318 Shkodër
4 Velabisht	67 Klos	130 Sinaballaj	193 Zejmen	256 Karinë	319 Shllak
5 Otlak	68 Labinot Fushë	131 Synej	194 Hotolisht	257 Pajovë	320 Shosh
6 Poshnjë	69 Labinot Mal	132 Barmash	195 Librazhd	258 Peqin	321 Veliponjë
7 Roshnik	70 Mollas	133 Çlirim	196 Lunik	259 Përparim	322 Vig-Mnelë
8 Sinjë	71 Papër	134 Ersekë	197 Orenjë	260 Shëzë	323 Temal
9 Terpan	72 Rrasë	135 Leskovik	198 Përrenjas	261 Ballaban	324 Buz
10 Ura Vajgurore	73 Shalës	136 Leskovik	199 Polis	262 Çarçovë	325 Fshat Memaliaj
11 Vertop	74 Shirgjan	137 Mollas	200 Qendër	263 Frashër	326 Krahës
12 Cukalat	75 Shushicë	138 Novoselë	201 Qukës	264 Këlcyrë	327 Kurvesh
13 Bulqizë	76 Tregan	139 Qendër	202 Stëblevë	265 Përmet	328 Lopës
14 Fushë Bulqizë	77 Zavalin	140 Drenovë	203 Stravaj	266 Qendër	329 Luftinjë
15 Gjoricë	78 Cakran	141 Gorë	204 Rrajcë	267 Sukë	330 Memaliaj
16 Trebisht	79 Dermenas	142 Korçë	205 Allkaj	268 Dishnicë	331 Qendër
17 Ostren	80 Fier	143 Lekas	206 Ballagat	269 Petran	332 Qesarat
18 Shupenzë	81 Frakull	144 Libonik	207 Bubullimë	270 Buçimas	333 Tepelenë
19 Zerqan	82 Ruzhdië	145 Liqenas	208 Divjakë	271 Çërravë	334 Baldushk
20 Martanesh	83 Kuman	146 Maliq	209 Dushk	272 Dardhas	335 Bërçullë
21 Delvinë	84 Kurjan	147 Moglicë	210 Fiershegan	273 Pogradec	336 Bërzhitë
22 Finiq	85 Levan	148 Mollaj	211 Golem	274 Proptisht	337 Dajt
23 Mesopotam	86 Libofshë	149 Pirg	212 Grabian	275 Trebinjë	338 Kamëz
24 Vergo	87 Mbrostar	150 Pojan	213 Gradishtë	276 Hudënisht	339 Kashar
25 Bilisht	88 Patos	151 Qendër	214 Hysgjokaj	277 Velçan	340 Ndroq
26 Qendër Bilisht	89 Portëz	152 Vithkuq	215 Karbunarë	278 Blerim	341 Paskuqan
27 Miras	90 Qendër	153 Voskop	216 Kolonjë	279 Fierzë	342 Petrelë
28 Hoçisht	91 Roskovec	154 Voskopojë	217 Krutje	280 Fushë Arrëz	343 Pezë
29 Progër	92 Strum	155 Vreshtas	218 Lushnje	281 Gjergjan	344 Prezë
30 Arras	93 Toponjë	156 Bubq	219 Rremas	282 Iballë	345 Farkë
31 Fushë-Çidhën	94 Zharrës	157 Cudhi	220 Tërbuf	283 Pukë	346 Shëngjergj
32 Kala e Dodës	95 Gramsh	158 Fushë Krujë	221 Gruemirë	284 Qelëz	347 Tiranë
33 Kastriot	96 Kudovjat	159 Kodër Thumanë	222 Kastrat	285 Qerret	348 Vaqarr
34 Lurë	97 Kushovë	160 Krujë	223 Kelmend	286 Qafë Mali	349 Vorë
35 Maqellarë	98 Lenie	161 Nikel	224 Koplik	287 Rrapë	350 Zall Bastar
36 Melan	99 Pishaj	162 Kozare	225 Qendër	288 Dhivër	351 Zall Herr
37 Fushë Muhur	100 Poroçan	163 Kuçovë	226 Shkrel	289 Konispol	352 Kërrabë
38 Peshkopi	101 Skëndërbegas	164 Perondi	227 Aranitas	290 Livadhja	353 Bajram Curri
39 Qendër Tomin	102 Kukur	165 Arrën	228 Ballsh	291 Lukovë	354 Bujan
40 Selishtë	103 Sult	166 Bicaj	229 Fratar	292 Sarandë	355 Bytyç
41 Sillovë	104 Tunjë	167 Bushtricë	230 Greshicë	293 Xarrë	356 Fierzë
42 Zall Dardhë	105 Antigone	168 Kolsh	231 Hekal	294 Aliko	357 Lekbibaj
43 Zall Reç	106 Cepo	169 Kukës	232 Kutë	295 Markat	358 Llugaj
44 Luzni	107 Dropull I Poshtëm	170 Malzi	233 Ngraçan	296 Ksamil	359 Margegaj
45 Durrës	108 Dropull I Sipërm	171 Zapod	234 Qendër	297 Bogovë	360 Tropojë
46 Gjevalaj	109 Gjirokastër	172 Shishtavec	235 Selitë	298 Çepan	361 Brataj
47 Ishëm	110 Lazarat	173 Shtiqën	236 Baz	299 Çorovodë	362 Himarë
48 Katund i Ri	111 Libohovë	174 Surroj	237 Derjan	300 Gjerbës	363 Kote
49 Maminas	112 Lunxhëri	175 Tërthore	238 Gurrë	301 Leshnjë	364 Novoselë
50 Manëz	113 Odrie	176 Topojan	239 Klos	302 Poliçan	365 Orikum
51 Rrashbull	114 Picar	177 Ujëmisht	240 Koms	303 Potom	366 Qendër
52 Shijak	115 Pogon	178 Grykë Çajë	241 Lis	304 Qendër	367 Selenicë
53 Sukth	116 Qendër Libohovë	179 Kalis	242 Macukull	305 Vendreshë	368 Sevaster
54 Xhafzotaj	117 Zagori	180 Fushë Kuqe	243 Burrel	306 Zhepë	369 Shushicë
55 Belsh	118 Fajza	181 Laç	244 Rukaj	307 Ana e Malit	370 Vllahinë
56 Bradashesh	119 Golaj	182 Mamurras	245 Suç	308 Bërdicë	371 Vlorë
57 Cërrik	120 Gjinaj	183 Milot	246 Ulëz	309 Bushat	372 Vranisht
58 Elbasan	121 Krumë	184 Balldren I Ri	247 Xibër	310 Dajç	373 Armen
59 Fierzë	122 Golem	185 Blinisht	248 Fan	311 Guri I Zi	
60 Funarë	123 Gosë	186 Dajç	249 Kaçinar	312 Hajmel	
61 Gjergjan	124 Helmës	187 Kallmet	250 Kthjellë	313 Vau I Dejës	
62 Gjinar	125 Kavajë	188 Kolç	251 Orosh	314 Postribë	
63 Gostimë	126 Kryevidh	189 Lezhë	252 Rrëshen	315 Pult	

Aneks A.2: PBB korrente sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2013




Qark

PBB në miliardë lekë



Aneks A.3: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2013



PBB për frymë në mijë lekë

NUTS 2

300 - 330

331 - 466

467 - 550

551 - 650

Shqipëria 466

Tabela B.1. Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistikore Nivel 1, 2, 3 për vitet 2008-2013

Milion Lekë

Kodi	Nivelet Statistikore	2008	2009	2010	2011	2012	2013*
AL	Republika e Shqipërisë	936.917	989.796	1.077.485	1.131.121	1.154.747	1.178.271
AL01	Veri / Durrës	221.411	236.724	266.491	270.270	276.762	279.039
AL011	Dibër	27.442	29.581	33.710	32.311	36.759	37.099
AL012	Durrës	89.229	94.938	109.731	108.297	110.082	113.178
AL013	Kukës	20.237	21.737	23.989	26.063	25.301	27.043
AL014	Lezhë	31.756	33.631	34.665	35.091	37.764	36.542
AL015	Shkodër	52.747	56.837	64.396	68.509	66.855	65.177
AL02	Qendër / Tiranë dhe Elbasan	447.898	474.632	504.342	511.989	517.345	530.815
AL021	Elbasan	68.694	73.294	86.749	84.744	83.040	88.324
AL022	Tiranë	379.204	401.338	417.592	427.245	434.305	442.491
AL03	Jug	267.608	278.441	306.652	348.861	360.639	368.418
AL031	Berat	37.015	39.098	44.128	45.682	42.472	43.471
AL032	Fier	96.066	96.827	113.752	132.415	148.034	155.030
AL033	Gjirokastrë	20.942	22.102	24.242	29.122	31.316	30.608
AL034	Korçë	52.629	56.225	59.968	66.009	67.405	68.823
AL035	Vlorë	60.956	64.189	64.562	75.633	71.413	70.486

* Vlerësimet për vitin 2013 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Tabela B.2. Produkti i Brendshëm Bruto në çmime korrente

Milion Lekë

Kodi	Nivelet Statistikore	2008	2009	2010	2011	2012	2013*
AL	Republika e Shqipërisë	1.080.676	1.143.937	1.239.644	1.300.624	1.332.811	1.350.555
